



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 14247 / Prot.

Tiranë, më 24.10.2022

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARIT

Nr. 103 Datë 24.10.2022

PËR



ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “OST” SHA TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve Nr. 83, datë 4.8.2022 “Mbi pasqyrat financiare të shoqërisë “ OST” sha Tiranë për vitin 2021” dhe Statutit të shoqërisë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “OST” sha Tiranë;

VENDOSA:

1. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 1,714,510,000 lekë, i barabartë me 1,714,510 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila;
2. Kapitali themeltar i shoqërisë pas zmadhimit bëhet 25,055,608,000 lekë, i barabartë me 25,055,608 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila;
3. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë;
4. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ngarkohet Drejtoria e shoqërisë “OST” sha Tiranë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

